

VENDIM
Nr. 716, datë 21.8.2013

**PËR DHËNIEN E BURSIVE PËR NXËNËSIT E SHKOLLËS SË MESME PROFESIONALE
“PETER MAHRINGER”, SHKODËR, PËR VITIN SHKOLLOR 2013-2014**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 6, 19 e 39 të ligjit nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ligjit nr. 9522, datë 25.4.2006 “Për ratifikimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Austrisë, për bashkëpunimin në fushat e kulturës, të arsimit dhe shkencës”, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 119/2012 “Për buxhetin e vitit 2013”, me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe Ministër i Arsimit dhe të Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dhënie nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës të 84 (tetëdhjetë e katër) bursave të studimit, nga të cilat 24 (njëzet e katër) për nxënës të viteve përgatitore dhe 60 (gjashtëdhjetë) për nxënës të viteve të para deri në vitin e katërt të shkollës së mesme profesionale “Peter Mahringer”, Shkodër, për vitin shkollor 2013-2014.

2. Vlera e bursës do të jetë 96 560 (nëntëdhjetë e gjashtë mijë e pesëqind e gjashtëdhjetë) lekë për nxënës në vit, me qëllim shlyerjen e tarifës mujore të shkollimit dhe për mbulimin e kostos së teksteve mësimore. Vlera e bursës do të paguhet për çdo nxënës pranë bankave të nivelit të dytë.

3. Fondi për mbulimin e këtyre bursave kalon nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës në Drejtorinë Arsimore Rajonale Shkodër.

4. Miratimi i bursave bëhet nga bordi i Fondacionit Shkollor Austriak, në mbështetje të kriterëve ekonomike dhe rezultateve të arritura nga secili nxënës/aplikant.

5. Bordi i Fondacionit Shkollor Austriak, pas miratimit të bursave, dërgon dokumentacionin përkatës në Drejtorinë Arsimore Rajonale Shkodër, e cila, pas konfirmimit të nxënësve që përfitojnë bursë, kalon masën e bursës në llogarinë personale të secilit nxënës.

6. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të mbulohen nga buxheti vjetor i Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës.

7. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Shkencës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha